



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Intervistë e Ministrit Sadri Ferati dhenë gazetës serbe "Danas".

Serbët duhet të dalin në zgjedhje nëse dëshirojnë t'i legjitimojnë komunat e reja

Komisioni qendror I zgjedhjeve se shpejti do të publikoi udhëzimin së si serbët e shpërngulur nga Kosova do mund të votojnë në zgjedhjet lokale të 15 nëntorit.



Danas: Në cilën masë procesi i Decentralizimit dhe zgjedhjet e ardhshme lokale kanë lidhshmëri dhe a pritni që Decentralizimi do të realizohet para zgjedhjeve, apo deri me 15 nëntor do të kryhet vetëm formimi i ekipeve përgatitore për komuna?

Ministri Ferati: Ashtu siç parasheh pakoja legjislative e Republikës së Kosovës dhe plani i veprimit për decentralizimin, komunat e reja legjitimohen me rastin e mbajtjes së zgjedhjeve lokale, që tani janë shpallur nga Presidenti i vendit z. Fatmir Sejdiu që data e zgjedhjeve lokale të jetë 15 nëntori i këtij viti.

Qeveria e Kosovës, përkatësisht Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në Bashkëpunim me Zyrën Civile Ndërkombëtare, tani kanë marrë vendim për emërimin e ekipeve përgatitore për komunën e Klllokotit, që kanë për detyrë përgatitjen e lokaliteteve për zgjedhjet lokale aty ku planifikohet të themelohen komunat e reja.

Danas: Kosova tani ka 30 komuna dhe tri pilot njësi komunale. Ç'farë do të jetë fotografia pas zgjedhjeve lokale ?

Ministri Ferati: Tri pilot njësitë komunale Hani i Elezit, Juniku dhe Mamusha, vitin e kaluar kanë marrë statutin legjitim të Komunave nga Kuvendi i Kosovës dhe funksionojnë njësoj si komunat tjera të Kosovës. Funksionimi i këtyre komunave është një model mjaft i mirë për tu siguruar se çka në të vërtetë sjell krijimi i komunave të reja dhe procesi i Decentralizimit, sikurse për shërbimet për qytetarët gjithashtu edhe në pavarësinë komunale në menaxhimin e drejtpërdrejtë të komunës me përgjegjësitë e veta dhe funksionim efikas të autoriteteve komunale.

Se cila do të jetë pasqyra e komunave të reja do ta determinoj pjesëmarrja e qytetarëve në zgjedhjet lokale, posaçërisht pjesëmarrja e qytetarëve në lokalitet që është planifikuar të bëhen

komuna. Komunat e reja i legjitimon vetëm dalja e serbëve në zgjedhjet lokale. Kosova është e vendosur për integrimin e të gjitha komuniteteve dhe besojmë që komuniteti serb nuk do ta humb këtë mundësi. Në po punojmë që pas zgjedhjeve lokale në Kosovë ti kemi 38 komuna me kompetenca të plota.

Danas: Kush krejt, sipas Ligjeve të Kosovës për shtetësi ka të drejtë të votoj dhe në cilën mënyrë eventualisht do të mund të votojnë serbët të larguar nga Kosova ?

Ministri Ferati: Ligji për zgjedhjet lokale përcakton saktë të drejtën e votimit për qytetarët e larguar nga Kosova, në këtë rast serbët që dëshirojnë të marrin pjesë në zgjedhje. Organizimi i procesit zgjedhor dhe votimit është kompetencë e Këshillit Qendror Zgjedhor dhe besojmë se së shpejti do të dalë me sqarimet se si do të votojnë qytetarët që momentalisht nuk ndodhen në Kosovë.

Danas: A keni kontaktuar zyrtarët në Beograd për ta zgjedhë pyetjen e votimit të njerëzve të shpërngulur dhe si mendoni ta zgjidhni atë problem ?

Ministri Ferati: Në vazhdimësi institucionet e Kosovës kanë apeluar tek qytetarët serb që të jenë pjesë e institucioneve të Kosovës dhe se Kosova ofron të drejta të barabarta për të gjithë ata që dëshirojnë të jetojnë këtu. Me Beogradin nuk kemi pasur kontakte të drejtpërdrejta, megjithatë unë si Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal kam kontakte të shpeshta me përfaqësues të serbëve të Kosovës dhe një numër i konsiderueshëm i tyre kanë shprehur gatishmërinë për të bashkëpunuar me ne.

Danas: Si është e rregulluar me Ligjet dhe Rregulloret që kandidatët për kryetar komunash mund të jenë vetëm personat që në tri vitet e fundit jetojnë në disa qytete, serbët e eliminuar të cilët janë gati nga të gjitha qytetet e Kosovës janë të ndjekur në vitin 1999 ? Shumica me këtë shohin "legalizimin e pastrimit etnik të qyteteve të Kosovës" gjë që nuk do të nxisë kthimin e Serbëve ?

Ministri Ferati: Kandidaturën për Kryetarë të komunave e definojnë saktë Ligji për Zgjedhjet Lokale, ku thuhet se kandidatët për kryetar komune duhet të jenë banorë së paku tri vite të asaj komune ku ai garon për Kryetar. Të gjithë ata që dëshirojnë të jetojnë në Kosovë të barabartë me të gjithë qytetarët janë të mirëseardhur, duke respektuar ligjet e Kosovës. Kosova është e hapur për të jetuar në paqe, demokraci duke respektuar të drejtat e të gjithëve pa dallime etnike, race, feje apo gjinie.

Për qytetarët që momentalisht nuk jetojnë në Kosovë nuk paraqiten pengesa për kandidaturat për Kryetar Komune, mjafton që ata të jenë të regjistruar në atë komunë dhe kanë ruajtur evindencën e tyre si banor të asaj Komune, ku pretendohet të jenë kandidat për Kryetar.

Danas: Plani i Ahtisarit, përveç tjerash parasheh edhe realizimin e regjistrimit të popullsisë para zgjedhjeve. A jeni tërhequr nga ajo dhe përse ?

Ministri Ferati: Regjistrimi i Popullsisë do të fillojë në muajin mars të vitit 2011, ky vendim është marrë dje në mbledhjen e Qeverisë së Kosovës. Republika e Kosovës është zotuar të zbatojë në tërësi planin e Presidentit Marti Ahtisari që përfshin edhe regjistrimin e popullsisë.

Danas: Cili është qëllimi i zgjedhjeve lokale, duke pasur para sysh që zgjedhjet e fundit janë mbajtur para dy viteve ?

Ministri Ferati: Zbatimi i Planit të Presidentit Ahtisari ka marrë zotimin e institucioneve të Kosovës dhe i tillë do të zbatohet. Mënyra më demokratike për funksionimin e një shteti demokratik patjetër se janë zgjedhjet, në veçanti tani që me legjislacionin e ri qytetarët e Republikës së Kosovës zgjedhin drejtpërdrejtë kryetarët e komunave të tyre. Gjithashtu zgjedhjet lokale mundësojnë instalimin e komunave të reja që përveç është edhe një e drejtë kushtetuese dhe ligjore është edhe një shans që ju jepet qytetarëve serb për të organizuar një jetë me të mirë dhe do të dëshironim që ata shfrytëzojnë këtë rast. Me Planin e Presidentit Ahtisari zgjedhjet e lokale janë vendosur në mandat dyvjeçar, ndërsa ato nacionale me mandat katërvjeçar.

Danas: Si i vlerësoni zërat e disa politikanëve në qarqet serbe, se me këto zgjedhje Prishtina dëshiron ti asgjësojë rezultatet e zgjedhjeve lokale të cilat me 11 maj 2008 në Kosovë i ka organizuar Beogradi ?

Ministri Ferati: Ne asnjëherë nuk i kemi pranuar ato zgjedhje dhe jemi të bindur se ato zgjedhje kanë qenë një improvizim që nuk i shërben interesave të qytetarëve të Kosovës. Pjesëmarrja e serbëve në zgjedhje do të themelojë komunat me legjitimitet dhe legalitet të plotë, në bazë të parimeve demokratike. Kosova ka Kushtetutën e vet, të votuar nga Parlamenti i Kosovës dhe ligjet bazike nëpërmjet të cilave e rregullon funksionimin e vendit, andaj mbajta e zgjedhjeve lokale është obligim ligjor i yni që nuk lidhet me ndonjë arsye tjetër.

Danas: Si i komentoni propozimet e disa politikanëve që procesi i Decentralizimit të ndahet nga zgjedhjet dhe i planit të Ahtisarit dhe për zgjedhjen e kësaj pyetje të angazhohen organizatat ndërkombëtare siç është Këshilli i Evropës ?

Ministri Ferati: Institucionet e Kosovës kanë për obligim dhe janë të përkushtuara që ta përfundojnë me sukses procesin e Decentralizimit dhe zgjedhjeve lokale. Natyrisht se do të bashkëpunojmë me Bashkësisë Ndërkombëtare në dobi të interesave që do ta ndihmonin realizimin e këtij procesi.

Danas: Dalja e Serbëve në zgjedhjet lokale të Kosovës ka qenë në përqindje . Ç'farë janë tash të priturat duke pasur parasysh që pjesëmarrja e Serbëve në ekipet përgatitore komunale është e motivuar para së gjithash për situatën në Kosovë , me të ardhura të larta ?

Ministri Ferati: Pagat e përcaktuara për Ekipet Përgatitore Komunale janë paga me standarde që aplikojnë institucionet e Kosovës për pozita të tilla dhe vlejnë për të gjitha komunat e Kosovës, ne jemi të kënaqur nëse vlerësohet se ato janë paga të mira. Presim që qytetarët serb të marrin pjesë në zgjedhje.

Danas: Udhëheqja Kosovare dhe bashkësia ndërkombëtare që dhjetë vite nuk kanë qenë kokën për shkeljen e të drejtave të serbëve për punë , gati të gjithë janë përjashtuar nga puna. Tani ju ofrohet punësim në ekipet përgatitore për Decentralizim . Mos është kjo një farë mënyre e manipulimit politik ?

Ministri Ferati: Ashtu siç e theksova, ndikimi që ka ushtruar Beogradi zyrtar mbi serbët e Kosovës ka ndikuar drejtpërdrejtë në jetën jo të mirë të tyre që momentalisht ata janë duke jetuar. Institucionet e Kosovës kanë apeluar vazhdimisht për inkuadrimin e serbëve në institucione, në këtë rast edhe punësimin të tyre. Shpallja e konkursit për Ekipet Përgatitore komunale, paga e tyre dhe procedurat që vijnë në vazhdim nuk janë manipulime politik, por tregues i qartë se Kosova ofron të drejta të barabarta për të gjithë ata që dëshirojnë të jetojnë këtu. Duhet pasur parasysh një detaj që shpallja e konkurseve është bërë mbi baze të kriterëve që përcakton saktë kualitetin e përfaqësuesve për ti udhëhequr këto ekipe përgatitore komunale. Aty ku nuk ka kualitet konkurset do të përsëriten. Kemi raste që edhe përkundër refuzimit të serbëve për të punuar në institucionet e Kosovës ata marrin paga nga buxheti i Kosovës dhe evidentohen akoma si të punësuar në Institucione. Refuzimi i disa pjesëtarëve të komunitete serb për të punuar në Institucione të Kosovës ka dërguar një mesazh jo të mirë për Bashkësinë e vet.

Autore: Jelena Tashic